



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## Seria 3: Statistikat Ekonomike

### Statistikat Afatshkurtra të Shërbimeve TM4 2020



## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bazë të planit të punës për vitin 2021, ka përgatitur për herë të parë publikimin e rezultateve të Statistikave Afatshkurtra të Shërbimeve, për periudhën TM1 2018 deri TM4 – 2020 (2017=100).

Publikimi është në përputhje me standardet e EUROSTAT –it, duke paraqitur indeksin e vëllimit të shërbimeve dhe indeksin e numrit të punësuarve në këto aktivitete ekonomike.

Duke ndjekur rekomandimet e Eurostat-it për uljen e barrës së bizneseve dhe për shkak të situatës së pandemisë (COVID 19), ASK për këtë publikim është bazuar në burimet administrative, (Administrata Tatimore e Kosovës).

Publikimi paraqet ecurinë në këto aktivitete ekonomike: Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave, Tregti me pakicë; Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierit); Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele dhe Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike; dhe Agjenci udhëtimi në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit në aktivitetet e Shërbimeve.

Nga ky tremujor (TM4 2020), e këndej ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK-së

Komentet dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura!

### Publikimi është përgatitur nga:

Ismajl Sahiti – Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit  
Hysni Elshani – Zëvendësues i Udhëheqësit të divizionit të Statistikave Ekonomike  
Vivianit Fejza – Zyrtar për Statistikat e Shërbimeve  
Qendresa Shala – Zyrtare për Statistikat e Ndërmarrjeve  
Dafina Kumnova – Zyrtare për Statistikat e Ndërmarrjeve  
Guxim Neziri – Zyrtar i TI-së për Statistikat Ekonomike  
Bekim Bojku – Zyrtar për Statistikat e Ndërmarrjeve

Ahmet Cakolli – Zyrtar për Dizajn

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën elektronike:

(E-mail: [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net))

## Simbolet dhe shkurtesat

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës  
NVE - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike  
RSB - Regjistri Statistikorë i Bizneseve  
SAN - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve

TM1 - Tremujori i parë  
TM2 - Tremujori i dytë  
TM3 - Tremujori i tretë  
TM4 - Tremujori i katërt

## Simbolet

: - Mungojnë të dhënat  
n/a - Nuk aplikohet

## Përmbajtja

	Faqe
1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.1. Objektivi dhe qëllimi .....	4
1.2. Fusha e mbulimit .....	4
1.3. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës .....	4
2. Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë .....	5
2.1. Definicione dhe përkufizime .....	5
2.2. Treguesit themelorë .....	5
3. Shërbimet - Tremujori TM4 2020 .....	6
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave.....	6
Transport, Magazinim dhe Postë .....	7
Hotele .....	7
Bar, Restorante .....	8
Informacion dhe Komunikacion .....	9
Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike .....	9
Agjenci udhëtimi .....	10

## 1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

### 1.1. Objektivi dhe qëllimi

Objektivi kryesor i këtijë publikimi (indeksi i shërbimeve) afatshkurtra të ndërmarrjeve është paraqitja e trendeve nëpër periudha tremujore në sektorët (G-45+46+47; H-49-63; I-55.1+56; J-58+61+62; M-71; N-79) të nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE Rev.2, nëpërmjet disa treguesve ekonomik , që mundëson krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat tremujore. Publikimi synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetet e shërbimeve (G-45+46+47; H-49-63; I-55.1+56; J-58+61+62; M-71; N-79), në të gjithë territorin e vendit. Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt.

Publikimi tremujor ka për qëllim të paraqes ecurinë e treguesve kryesorë ekonomik të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore..

### 1.2. Fusha e mbulimit

Bazuar në aktivitetin kryesor, në këtë anketë tremujore janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61,62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

### 1.3. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Të dhënat janë të bazuara në burimet administrative (ATK) dhe është marre e gjithë popullata nëpër këto sektorë sipas fushës së mbulimit.

## 2. Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

### 2.1. Definicione dhe përkufizime

**Ndërmarrja** është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

**Ndërmarrje aktive** - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

**Vlera e volumit nga Shërbimet** - paraqet vëllimin e realizuar nga shërbimi duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

**Indekset** - Shprehin raportin në periudha të caktuara kohore të një variable të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

**Numri i të punësuarëve** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

**Indeksi i numrit të punësuarëve** - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar në periudha të ndryshme.

### 2.2. Treguesit themelorë

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2017 =100.

Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variable të dhënë ose tërësi variablash.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Matë ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficienteve të përdorur , etj.

### 3. Shërbimet - Tremujori TM4 2020


Treguesit tremujor mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim, Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

#### Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshinë tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 22.34 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 16.38 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punëtorve në Tregti.




## Transport, Magazinim dhe Postë

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 10.46 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2019.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 18.19 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punetorve në Transport, Magazinim dhe Postë.




## Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 62 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Indeksi i numrit të të punësuarëve shënoi rritje 2.69 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Fig.3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punëtorve në Hotele.




## Bar, Restorante

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e parë 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 21.89 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 15.01 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punëtorve në Bar-Restorante.




## Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 9.87 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2019.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi renje 18.70 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2019.

Fig.5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punëtorve në informacion dhe komunikacion.




## Aktivitete Arkitekturore dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivitete Arkitekturore dhe Inxhinierike, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 32.21 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 3.28%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punetoreve në Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike.




### Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e katërt 2020, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 31.75 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2019.
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3.34 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum dhe numri i punetoreve në Agjenci udhëtimi.



Statistikat Afatshkurtra të Shërbimeve TM1 2018 - TM4 2020

Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2017=100)

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020
G	45+46 +47 Tregti	84.97	112.24	123.88	120.76	117.98	146.52	166.74	168.08	93.18	91.59	114.94	130.54
H	49 - 63 Transport dhe Magazininim	88.75	117.28	146.64	114.32	98.43	129.37	166.47	142.19	100.25	60.60	102.09	127.32
I	55.1 Hotele	78.71	94.13	140.78	107.77	91.62	118.89	184.75	117.91	69.54	21.77	49.42	44.81
I	56 Bar-Restorane	90.44	102.15	146.82	113.06	103.30	118.17	174.97	134.25	98.74	43.84	98.00	104.87
J	58, 61, 62 Informacioni dhe Komunikacion	89.65	97.96	117.69	126.69	92.16	91.62	123.36	126.48	86.03	82.22	107.23	138.97
M	71 Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike	70.54	92.62	122.17	138.35	90.24	138.17	164.25	256.89	64.05	83.93	122.61	174.14
N	79 Agjenci udhëtimi	78.04	113.81	182.24	76.05	90.70	137.95	219.63	92.29	70.84	11.84	71.34	62.99

Tab. 2 Ndryshimi në përqindje me periudhën paraprake

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020
		TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020
G	45+46 +47 Tregti	-21.05	32.09	10.38	-2.53	-2.30	24.19	13.80	0.81	-44.56	-1.70	25.50	13.56
H	49 - 63 Transport dhe Magazininim	-15.60	32.14	25.04	-22.04	-13.90	31.43	28.68	-14.58	-29.49	-39.55	68.47	24.71
I	55.1 Hotele	-13.54	19.60	49.55	-23.45	-14.99	29.76	55.39	-36.18	-41.03	-68.69	127.04	-9.34
I	56 Bar-Restorane	-6.73	12.95	43.73	-22.99	-8.64	14.40	48.06	-23.27	-26.45	-55.60	123.52	7.01
J	58, 61, 62 Informacioni dhe Komunikacion	-21.51	9.26	20.14	7.65	-27.25	-0.59	34.65	2.53	-31.98	-4.44	30.43	29.60
M	71 Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike	-46.23	31.30	31.90	13.25	-34.77	53.10	18.88	56.40	-75.07	31.03	46.09	42.03
N	79 Agjenci udhëtimi	6.96	45.84	60.12	-58.27	19.27	52.09	59.22	-57.98	-23.24	-83.28	502.30	-11.71

Tab 3. Ndryshimi në përqindje me periudhën e njëjtë të vitit paraprake

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020
		TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019
G	45+46 +47 Tregti	9.16	11.59	8.72	12.19	38.84	30.54	34.59	39.19	-21.02	-37.49	-31.06	-22.34
H	49 - 63 Transport dhe Magazininim	16.68	17.70	23.08	8.73	10.91	10.31	13.52	24.38	1.85	-53.16	-38.67	-10.46
I	55.1 Hotele	5.42	-3.25	2.75	18.39	16.41	26.30	31.23	9.41	-24.10	-81.69	-73.25	-62.00
I	56 Bar-Restorane	8.81	11.36	14.54	16.60	14.22	15.69	19.17	18.74	-4.41	-62.90	-43.99	-21.89
J	58, 61, 62 Informacioni dhe Komunikacion	10.44	5.44	5.37	10.91	2.80	-6.47	4.82	-0.16	-6.65	-10.26	-13.08	9.87
M	71 Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike	25.61	-17.27	21.31	5.47	27.94	49.18	34.45	85.68	-29.02	-39.26	-25.35	-32.21
N	79 Agjenci udhëtimi	15.35	8.29	18.12	4.23	16.23	21.20	20.52	21.36	-21.89	-91.41	-67.52	-31.75

Tab. 4 Indeksi i numrit të të punësuarve ne Shërbime (2017=100)

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020	
G	45+46 +47	Tregti	105.98	110.15	112.21	111.89	151.24	156.38	159.94	162.36	124.94	121.75	132.32	135.76
H	49 - 63	Transport dhe Magazininim	103.16	106.52	108.13	107.22	107.94	110.79	115.09	118.34	86.43	80.79	93.62	96.82
I	55.1	Hotele	98.78	101.26	109.03	102.63	89.56	95.12	109.23	104.59	116.48	93.22	108.38	107.40
I	56	Bar-Restorane	104.07	110.73	119.37	116.22	109.08	114.39	126.60	127.98	141.56	116.49	145.63	147.20
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	103.66	108.31	110.77	114.61	117.52	120.44	122.66	122.25	93.06	89.87	95.47	99.39
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	105.49	111.73	113.53	119.72	131.02	140.85	152.91	157.41	135.63	132.97	147.96	152.25
N	79	Agjenci udhëtimi	101.27	109.64	114.86	115.83	104.79	109.88	112.31	108.79	118.98	98.12	114.25	112.43

Tab. 5 Ndryshimi në përqindje me periudhën paraprake

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020	
		TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	
G	45+46 +47	Tregti	2.36	3.94	1.87	-0.29	35.17	3.40	2.28	1.51	-23.05	-2.55	8.68	2.60
H	49 - 63	Transport dhe Magazininim	1.87	3.26	1.51	-0.84	0.68	2.64	3.88	2.82	-26.97	-6.53	15.89	3.41
I	55.1	Hotele	1.48	2.51	7.68	-5.87	-12.73	6.20	14.84	-4.25	11.37	-19.97	16.26	-0.90
I	56	Bar-Restorane	2.89	6.40	7.80	-2.64	-6.14	4.87	10.67	1.09	10.60	-17.71	25.02	1.08
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	1.10	4.49	2.27	3.47	2.54	2.48	1.84	-0.33	-23.88	-3.44	6.23	4.11
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	-1.02	5.92	1.60	5.45	9.44	7.50	8.56	2.95	-13.84	-1.96	11.27	2.90
N	79	Agjenci udhëtimi	0.72	8.26	4.76	0.84	-9.53	4.86	2.21	-3.13	9.36	-17.53	16.44	-1.59

Tab 6. Ndryshimi në përqindje me periudhën e njëjtë te vitit paraprakë

		TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020	
		TM1 2017	TM2 2017	TM3 2017	TM4 2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018	TM1 2019	TM2 2019	TM3 2019	TM4 2019	
G	45+46 +47	Tregti	11.17	10.91	10.20	8.07	42.71	41.97	42.55	45.11	-17.39	-22.14	-17.27	-16.38
H	49 - 63	Transport dhe Magazininim	6.16	6.36	6.62	5.88	4.64	4.01	6.44	10.38	-19.93	-27.08	-18.65	-18.19
I	55.1	Hotele	2.72	0.78	2.83	5.44	-9.33	-6.06	0.18	1.91	30.05	-1.99	-0.78	2.69
I	56	Bar-Restorane	10.71	11.54	13.05	14.91	4.82	3.31	6.06	10.12	29.77	1.83	15.03	15.01
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	8.04	9.40	8.06	11.78	13.37	11.20	10.74	6.66	-20.81	-25.39	-22.17	-18.70
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	12.58	13.15	12.43	12.33	24.20	26.06	34.69	31.49	3.52	-5.59	-3.23	-3.28
N	79	Agjenci udhëtimi	4.38	9.58	12.20	15.20	3.47	0.22	-2.22	-6.07	13.54	-10.71	1.73	3.34

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili kua hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** + 383 (0) 38 200 31 129
- **Kryeshefi Ekzekutiv:** + 381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** + 383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>